

## Formular i Syllabusit të Lëndës

<b>Të dhënat bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia Akademike</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës</b>	<b>Kurs i Avancuar i të Drejtës Pronësore</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi i Lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve</b>	<b>I</b>
<b>Numri i orëve për javë:</b>	<b>2+1</b>
<b>Credits – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Vendi/lokacioni:</b>	<b>Prishtinë</b>
<b>Ligjëruesi i lëndës:</b>	<b>Prof. Dr. Abdulla Aliu, Prof. Dr. Haxhi Gashi; Asist. Mr. Sc. Qerkin Berisha;</b>
<b>Detajet kontaktuese</b>	<a href="mailto:haxhi.gashi@uni-pr.edu">haxhi.gashi@uni-pr.edu</a> <a href="mailto:abdulla.aliu@uni-pr.edu">abdulla.aliu@uni-pr.edu</a> <a href="mailto:qerkin.berisha@gmail.com">qerkin.berisha@gmail.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Lënda përfshinë rishikimin analitik të të drejtave pronësore dhe të drejtave të tjera sendore (servitutet, hipotekat, pengjet, e drejta e ndërtimeve dhe barrat pronësore). Kjo lëndë do të fokusohet në adresimin e të drejtave thelbësore të pronësisë si kuptimi (përmbajtja) e pronësisë, fitimi (krijimi) i pronësisë, transaksionet (transfert) e të drejtave pronësore, kufizimet në të drejtat pronësore dhe ndërprerja e të drejtave pronësore. Po ashtu, do të shqyrtohen të drejtat e tjera sendore pasq që janë domosdoshmërisht të ndërlidhura me të drejtën e pronësisë, duke e studiuar deri në shkallën sa është në interes të lëndës se si trajtohen të drejtat pronësore nga perspektiva e transaksioneve komerciale. Aspekte të të drejtës pronësore do të rishikohen nga konteksti i dispozitave në fuqi në Kosovë por edhe aspektet krahasimore me ligjet e vendeve tjera.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kursit është ofrimi i njohurive ligjore dhe praktike për studentët në atë mënyrë se si të kuptohen më mirë 1) dispozitat ligjore me të cilat rregullohet e drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera sendore dhe 2)</p>

trajtimi profesional- Si dhe në çfarë mënyre pjesëmarrësit në transaksione të pronësisë, i plotësojnë nevojat dhe qëllimet e tyre, mund të negociojnë, të bartin të drejtat dhe detyrimet, marrjen ose bartjen e rrezikut në transaksione pronësore, avokimin dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe drejtave tjera sendore, rëndësia ekonomike e pronës dhe e drejtave tjera sendore etj. Përmes këtij kursi synohet që studentët të përgatiten me njohuri të nevojshme për zbatimin e tyre në praktikë.

**Rezultatet e pritura të nxënies:**

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të aftësohen për kryerjen e veprimeve si në vijim:

1. Të jenë në gjendje për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore nga fusha e të drejtës pronësore;
2. Të kuptoj nocionet dhe institutet e të drejtës së pronësisë dhe të drejtave tjera sendore si: servituteve, hipotekës, pengut, të drejtës së ndërtimit dhe barrëve sendore.
3. Të paraqes argumente verbale dhe me shkrim në çështjet e të drejtës së pronësisë në emër dhe për llogari të klientëve afarist
4. Të përdor metoda të duhura për konstruimin e një të drejte adekuate pronësore që i përgjigjet nevojave të ekonomisë së tregut të lirë.

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Total
Ligjeratë	2	1/15	30
Ushtrime praktike/laboratorike	1	1/15	15
Punës praktike	1	1/15	15
Kontakti me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15

Ushtrime ne terren	1	1/15	15
Kollokvium, seminare	2	2/5	10
Detyrë Shtëpie	2	1/5	10
Self learning time of student (at the library or at home)	2	1/15	15
Final preparation for the exam	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	1/1	5
Projekte, prezantime,etj	10	1/1	10
<b>Totali</b>	5 ECTS	Totali	150

**Shënim: 1 ECTS kredit = 30 orë të angazhimit, p.sh. nëse rasti ka 7 ECTS kredite, një student duhet të ketë 210 orë angazhim gjatë semestrit.**

**Metodologjia e mësim:**

Kursi do të organizohet përmes ligjëratave, seminareve dhe shqyrtimin e rasteve

*Ligjëratat:* mbajtja e ligjëratave do të bëhet në forme gojore e përcjell me power point, interaktive – bashkëbisedim me studentët, diskutim i çështjeve praktike

*Seminaret:* çdo studentë duhet të punoj një punë kërkimore-shkencore që do të prezantohet përmes seminarit. Seminari duhet të jetë në mes 8 dhe 10 faqe, formati A4, formati i shkronjave fonti- time new roman, madhësia 12, hapësira 1.5. Çdo seminar duhet të ketë temën e trajtimit e cila formohet në formë të hipotezës apo pyetjes së hapur e cila duhet ta gjejë përgjigjen e qartë në përmbajtjen e seminarit me theks të veçantë në konkluzion. Tema e seminarit caktohet në konsultim me profesorin. Seminari duhet të përbëj një punë të pavarur shkencore dhe e shoqëruar me referenca (fusnota) të qarta dhe çdo kopjim ose plagjiaturë, do të reflektohet me vlerësim negativ në vlerësimin përfundimtar.

*Raste studimi-simulimi:* gjatë kursit studentët do të kenë punë praktike të cilat do të jenë në formën e rasteve të studimit që mbahen në klasë. Studentët do të ngarkohen edhe me raste studimi të cilat duhet të punohen në si detyrë shtëpie dhe të sjellën te profesori në kohen e kërkuar. Rastet e studimit përbëhen nga formulime me shkrim të rasteve nga praktika dhe dhënia për detyrë studentëve për të zgjidhur rastin e tillë në pajtim me dispozitat ligjore. Simulimi i rasteve paraqet formë praktike përmes së cilës studentët aftësohen në ushtrime praktike duke simuluar raste dhe marrë rolin e palëve dhe organeve tjera në kontestet pronësore.Këto

	simulime do të bëhen pjesë e Klinikës Juridike.		
<b>Evaluation methods:</b>	<p>Vlerësimi do të bëhet përmes pjesëmarrës, angazhimit në seminar, angazhimit në rast të studimit, dhe provimi përfundimtar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Pjesëmarrja e studentëve</i> 10%</li> <li>- <i>Seminari</i> 10%</li> <li>- <i>Rasti i studimit</i> 20% (10% rastet e studimit në klasë dhe 10% rastet e studimit detyrë shtëpie)</li> <li>- <i>Provimi përfundimtar</i> 60% (provimi përfundimtar organizohet në formë me shkrim i cili përbëhet nga 50% e pikëve pyetje alternative dhe të hapura, 25% ese dhe 25% rast i shkurtër studimi. Kalueshmëria me 60% e pikëve të fituara).</li> </ul> <p><b><u>Ndërtimi i notës:</u></b></p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 50%; vertical-align: top;"> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>%</u></li> <li>• 91-100</li> <li>• 81-90</li> <li>• 71-80</li> <li>• 61-70</li> <li>• 51-60</li> </ul> </td> <td style="width: 50%; vertical-align: top;"> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b><u>Nota</u></b></li> <li>• 10 (dhjetë)</li> <li>• 9 (nëntë)</li> <li>• 8 (tetë)</li> <li>• 7 (shtatë)</li> <li>• 6 (gjashtë)</li> </ul> </td> </tr> </table>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>%</u></li> <li>• 91-100</li> <li>• 81-90</li> <li>• 71-80</li> <li>• 61-70</li> <li>• 51-60</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b><u>Nota</u></b></li> <li>• 10 (dhjetë)</li> <li>• 9 (nëntë)</li> <li>• 8 (tetë)</li> <li>• 7 (shtatë)</li> <li>• 6 (gjashtë)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <u>%</u></li> <li>• 91-100</li> <li>• 81-90</li> <li>• 71-80</li> <li>• 61-70</li> <li>• 51-60</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b><u>Nota</u></b></li> <li>• 10 (dhjetë)</li> <li>• 9 (nëntë)</li> <li>• 8 (tetë)</li> <li>• 7 (shtatë)</li> <li>• 6 (gjashtë)</li> </ul>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura Bazike:</b>	<p>Abdulla Aliu, “E drejta sendore (pronësia)”, Prishtinë, 2004</p> <p>Haxhi Gashi, “Fitimi dhe humbja e pronësisë sipas ligjit për pronësinë dhe të drejta tjera sendore: Influenca e Kodit Civil Gjerman-BGB në Ligjin e Kosovës”, published in the International Conference on property legislation and its reform in Kosovo and the region, Prishtinë 28-29 June 2010.</p> <p>Francesco Galgano, “E drejta private 1 (pronësia)”, Luarasi, Tiranë, 2003</p> <p>Ugo Mattei, “Basic Principles Of The Property Law: A Comparative Legal and Economic Introduction”, London 2000, ISBN: 0-313-31186-2, ISSN: 0147-1074</p> <p>Elizabeth Cook (eds.), “Modern Studies in Property Law”, Vol. III, Oxford, 2005, ISBN: 1-84113-558-5</p>		

	<p>Ulrich Drobnig, Henk J. Snijders &amp; Erik-Jan Zippro (eds.), “Divergences of Property Law, an Obstacle to the International Market?”, European Law Publishers GmbH, Munchen, 2006, ISBN-10 3-935808-96-8, ISBN-13 978-3-935808-96-5</p> <p>LAWS:</p> <p>Law on Property and Other Real Rights, Official Gazette of the Republic of Kosovo, no. 57/2009 dated 4 August 2009.</p> <p>Law No. 2002 / 5 on the Establishment of rights in immovable property, as amended by Law no. 2003/13.</p> <p>Law no. 2003/25, the cadastre, as amended by Law no. 02/L-96.</p>
<p><b>Literatura shtesë</b></p>	<p>Elizabeth Cook (eds.), “Modern Studies in Property Law”, Vol. 4, Oxford, 2007</p> <p>Haxhi Gashi, “Mbrojtja e pronësisë private në rastet e shpronësimit: analizë e legjislacionit pozitiv në Kosovë në raport me standardet ndërkombëtare – praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, Revista, E Drejta nr. 4, Prishtinë, 2009</p> <p>Ejup Statovci, “Marrëdhëniet pronëso-ro-juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës”. Prishtinë, 1977, Ribotim 2009</p> <p>Ejup Statovci, “Pronësia, origjina dhe zhvillimi (studim komparativ)”. Prishtinë, 1983, Ribotim 2009</p> <p>Ejup Statovci, “Mbrojtja e Pronësisë: studim komparativ”. Prishtinë, 1980, Ribotim 2009</p> <p>Donatella Porrini &amp; Giovanni Battista Ramello, “Property Rights Dynamics: A law and economics perspective”, New York, 2007, ISBN10: 0-415-36382-9 (hbk), ISBN10: 0-201-01498-7 (ebk).</p>
<p><b>Plani i dizajnuar i mësimit</b></p>	
<p><b>Java</b></p>	<p><b>Ligjerata që do të zhvillohet</b></p>
<p>Java I:</p>	<p>-- Kuptimi i të drejtave sendore, në mënyrë të veçantë e</p>

	<p>drejta e pronësisë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-parimet e të drejtave sendore</li> <li>-baza ligjore e të drejtave pronësore</li> </ul>
Java II:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- E drejta e pronësisë në sistemet ligjore në botë</li> <li>- Shqyrtim i të drejtave të veçanta pronësore në të Drejtën Kontinentale dhe të drejtën Zakonore</li> </ul>
Java III:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptimi dhe llojet e pronësisë</li> <li>- fitimi dhe humbja e pronësisë</li> <li>- objekti i pronësisë</li> </ul>
Java IV:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Transaksionet pronësore</li> <li>- Kalimi i pronësisë mbi sendet e luajtshme</li> <li>- Kalimi i pronësisë mbi sendet e paluajtshme</li> </ul>
Java V:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rishikim i veçantë i kontratave për shitblerje të pronës</li> <li>- kalimi i të drejtave pa të meta ligjore</li> <li>- shitja e sendit pa të meta teknike</li> </ul>
Java VI:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistrimi i të drejtave pronësore në patundshmëri</li> <li>- Llojet e regjistrimeve të të drejtave pronësore</li> </ul>
Java VII:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nocioni i servituteve</li> <li>- partimet e servituteve</li> <li>- fitimi dhe humbja e servitutit</li> </ul>
Java VIII:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Llojet e servituteve</li> <li>- servitutet sendore</li> <li>- servitutet personale</li> <li>- mbrojtja e servituteve</li> </ul>
Java IX:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rëndësia ekonomike e servituteve</li> <li>- krijimi i servituteve për operimin e nevojave afariste të biznesit (energja, ngrohja, uji, etj.)</li> </ul>
Java X:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sigurimi i kërkesave të kreditorëve me prone</li> <li>- Llojet e mjeteve të sigurimit të pronës</li> <li>- hipotekat</li> <li>- pengjet</li> </ul>
Java XI:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rëndësia e ofrimit të kreditorëve me kërkesa pronësore</li> <li>- Siguria juridike dhe fleksibiliteti I përmbushjes së kërkesave</li> </ul>

Java XII:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- E drejta e ndërtimit</li> <li>- kuptimi ligjor I të drejtës së ndërtimit</li> <li>- specifikacionet si të drejta ekskluzive sendore</li> <li>- barra sendore</li> </ul>
Java XIII:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rëndësia ekonomike e të drejtave të ndërtimit dhe barrës sendore</li> <li>- Mundësia e krijimit të transaksioneve tregtare me të drejtat e ndërtimit</li> </ul>
Java XIV:	- Rishikimi, diskutimi dhe vlerësimi i lëndës
Java XV:	- Provimi përfundimtar

**Academic policies and rules of conduct:**

- a) Gjatë vijimit të kursit duhet të ruhet integriteti personal dhe akademik i mësimdhënësit dhe studentit
- b) Pjesëmarrja e studentëve është e detyrueshme (çdo mungesë e paarsyeshme reflektohet në vlerësimin përfundimtar)
- c) Studentët duhet ti përmbushin detyrimet e dhëna gjatë punës praktike dhe detyrimeve të shtëpisë. Mungesa e përmbushjes së detyrimeve reflektohet në kalueshmërinë e provimit.
- d) Studentët duhet ti përmbahen rregullave disiplinore të mbarëvajtjes së ligjëratave, ushtrimeve dhe provimit.
- e) Plagjiatura dhe format e ndryshme të kopjimit janë të ndaluara dhe reflektohen në vlerësimin negativ për studentin dhe ndëshkime tjera sipas rregullave përkatëse ligjore.